

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

PML 02/2014

Date: 6 mars 2014

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Bertil Ahnborg si kryetar i kolegjit dhe Gjyqtareve të Kosovës Emine Mustafa dhe Valdete Daka si anëtare të kolegjit, në prani të Zyrtares ligjore të EULEX-it Natalie Dawson, duke vepruar në cilësi të procesmbajtëses, në lëndën kundër të pandehurit:

H.G. [REDACTED] i biri i [REDACTED] dhe [REDACTED], i lindur më [REDACTED] në [REDACTED] me kombësi shqiptar, i pamartuar, jeton me prindër, ka mbaruar shkollën e mesme, i papunë, me gjendje të dobët ekonomike, aktualisht në vuajtje të dënimit.

Në lidhje me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të 10 qershorit 2010, P.nr. 24/09; e ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës si shkallë e dytë më 7 shkurt 2012, Ap-Kz 373/10, e ndryshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin e 23 prillit 2013, Api-Kz 7/2012, i dënuar për veprat penale në vijim:

1. Vrasje në kundërshtim të nenit 146 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së)
2. Vrasje në tentativë në kundërshtim të nenit 146 në lidhje me nenin 20 të KPK-së
3. Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të Armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së.

Sepse, më 20 shtator 2008, në lagjen "Gashi", në fshatin Kryshevci, Komuna e Skenderajt, me pushkë automatike AK 47, ka shtënë 10 plumbë në drejtim të [REDACTED] dhe [REDACTED] duke e qëlluar dhe shkaktuar vdekje të menjëherëshe [REDACTED] dhe duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore. K.G. A.G.

Duke vendosur në lidhje me kërkasen për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga X. H. avokat, në emër të pandehurit H. G. dhe pas shqyrtimit të mendimit të Prokurorit të Shtetit, KMLP II. Nr. 2/2014 të datës 10 janar 2014.

Pas këshillimit dhe votimit, në pajtim me nenin 435 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), Gjykata Supreme lëshon këtë:

AKTGJYKIM

H.G.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të pandehurit [REDACTED] e datës 17 dhjetor 2013 e paraqitur në emër të tij nga avokati mbrojtës [REDACTED] REFUZOHEZ SI E PABAZUAR.

X.H.

ARSYETIM



I. Historia e procedurës:

Aktakuza në këtë procedurë është ngritur nga Prokuroi më 10 mars 2009. Ajo është konfirmuar më 11 janar 2010 në lidhje me vrasjen dhe vrasjen në tentativë. Ajo është ndryshuar nga Prokurori më 27 prill 2010, duke e shtuar veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve. I pandehuri është shpallur fajtor nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë për veprën penale armëmbajtje, mirépo është liruar nga akuzat tjera më 10 qershor 2010 me anë të aktgjykimit P. nr. 24/09. Mbrojtja ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës më 25 gusht 2010, kurse Prokuroi më 10 gusht 2010.

Më 7 shkurt 2012, Gjykata Supreme si gjykatë e shkallës së dytë ka lëshuar aktgjykimin Ap – Kz 373/10 me të cilin ka ndryshuar aktgjyimin e shkallës së parë. Gjykata Supreme ka shpallur të pandehurin fajtor gjithashtu edhe për Vrasje në kundërshtim të nenit 146 të KPK-së dhe Vrasje në tentativë në kundërshtim të nenit 146 në lidhje me nenin 20 të KPK-së dhe e ka dënuar atë me 15 vite burgim, sipas nenit 147 pikës 11 të KPK-së. Kohëzgjatja e burgimit për veprën armëmbajtje është ndryshuar në 1 vit dhe 6 muaj. I është shqiptuar dënim i unik prej 16 viteve burgim.

Më 30 mars 2012, mbrojtja ka paraqitur ankesë. Më 23 prill 2013, Gjykata Supreme si gjykatë e shkallës së tretë ka lëshuar aktgjyimin Api – Kzi. 7/2012, duke ndryshuar aktgjyimin e saj të mëparshëm vetëm në lidhje me dënimin. Gjykata Supreme ka sqaruar se kur i pandehuri është akuzuar dhe shpallur fajtor për veprat penale Vrasje dhe Vrasje në tentativë në kundërshtim të nenit 146 të KPK-së, neni 147 nuk është i aplikueshëm gjatë vendosjes së dënit. Dënim i unik i shqiptuar ka qenë 15 vite dhe 6 muaj, kurse dënimet individuale ishin:

- Vrasje – 12 vite
- Vrasje në tentativë – 3 vite
- Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve – 1 vit e 6 muaj

Më 25 gusht 2013, i pandehuri ka paraqitur kërkesë përmbrojtje të ligjshmërisë. Avokati mbrojtës është caktuar më 5 nëntor 2013 dhe ka paraqitur një plotësim të kërkesës më 20 dhjetor 2013, duke iu mundësuar një gjë e tillë nga Gjykata Themelore në Mitrovicë. Më 10 janar 2014, Prokurori është përgjigjur duke i propozuar Gjykatës Supreme që ta refuzojë kërkesën e të pandehurit përmbrojtje të ligjshmërisë.

II. Gjetjet e Gjykatës:

Kërkesa përmbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur me kohë nga peronat e autorizuar.

Kërkesa është paraqitur mbi bazën se gjykatat e mëparshme kanë gabuar në vlerësimin e tyre të lëndës. Avokati mbrojtës thekson se gjykatat e mëparshme nuk kanë marrë parasysh nëse ka pasur mbrojtje putative, duke qenë kështu, në situatë të at-qasshme, H. S. [REDACTED] me të vërtetë ka besuar se gjendet në rrezik por ka qenë gabim. Avokati mbrojtës kërkon nga Gjykata Supreme të gjej se kjo mbrojtje është dashur të çojë në lirimin e të pandehurit.

Gjykata Supreme nënvizon se kërkesa pér mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet mbi bazën e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike të lëndës, sipas nenit 132, paragrafit 2 te KPK-së. Prandaj, gjatë marrjes më një kërkesë të tillë, Gjykata Supreme nuk duhet të lëshohet në meritat e lëndës dhe provat. Pér ta marrë parasysh mbrojtjen putative tanë të propozuar nga avokati mbrojtës, do të kërkonte një hulumtim në provat dhe gjetjet nga Gjykata Supreme dhe tregon vlerësim të gabuar të gjykatave të mëparshme.

Pér më tepër, dhe në çdo rast, gjykata Supreme vëren gjetjet e Gjykatës Supreme si gjykatë e shkallës së dytë më 7 shkurt 2013. Në faqen 13 të dokumentit në gjuhën angleze, kolegji gjen 'Përgjegjësia penale e [REDACTED] nuk është përjashtuar sipas H.G. nenit 8 të KPK-së, sepse i pandehuri ka mundur të ketë supozuar gabimisht se ka qenë në situatë me rrezik pér jetën dhe se mbrojtja e zgjedhur e tij ka qenë e domosdoshme. Siç është theksuar, ai ka qenë në dijeni pér mungesën e rrezikut eminent dhe të vazhdueshëm dhe mospërputhjes së mjeteve të tij të mbrojtjes, si dhe shkallën e agresionit.' Duke qenë kështu, pér kolegjin është e qartë se kolegji i mëparshëm ka marrë parasysh mbrojtjen putative. Kolegji i mëparshëm ka vlerësuar provat dhe ka përfunduar se [REDACTED] nuk H.G. ka mundur të jetë në lajthitje të tillë në të gjitha rrethanat pasi që situata tanimë kishte përfunduar.

Duke konstatuar se kolegji i mëparshëm ka shqyrtau mundësinë se një mbrojtje putative e tillë ka ekzistuar, dhe ka refuzuar atë mbrojtje në bazë të provave dhe gjetjeve faktike, Gjykata Supreme patjetër është dashur të konstatoj se nuk ka pasur shkelje të ligjit penal dhe pér këtë arsy patjetër është dashur të refuzoj këtë kërkesë pér mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar.

Kryetar i kolegjit:

Bertil Ahnborg
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtëse:

Natalie Dawson
Republika e Kosovës
Repzyrtare legjore
GJYKATA SUPREME - VRHOVNI SUD
PRISHNË - PRIŠTINA

Emine Mustafa,
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Valdete Daka
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PML 20/2014
6 mars 2014